



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

LIDERËT E UÇK-së NË PRILL TË VITIT 2023 KËRKUAN NDRYSHIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV PËR KOMPENSIMIN E EKIPEVE MBROJTËSE | FAQE 4-5


LIDERËT E UÇK-së ALARMUAN INSTITUCIONET SE PO RREZIKOHET MBROJTJA E TYRE



Avokati i Hashim Thaçit, Gregory Kehoe, së bashku me ekipin e tij, në fund të muajit janar ka parashtruar kërkesë që të tërhiqet nga mbrojtja e ish-presidentit për shkak të moskryerjes së obligimeve financiare. Lidhur me vështirësitë financiare, liderët e UÇK-së në prill të vitit 2023 i janë drejtuar me një

kërkesë Ministrisë së Drejtësisë për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ, i cili parashihet kompensimin e ekepeve mbrojtëse. Në këtë kërkesë, avokatët, në emër të Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, kanë vlerësuar se udhëzimi aktual administrativ është duke e rrezikuar mbrojtjen e

- Udhëzimin Administrativ nuk reflekton kostot aktuale të mbrojtjes. Po rrezikohet mbrojtja efikase dhe efektive në rastin e liderëve të UÇK-së



katërshes së UÇK-së. Sipas kësaj kërkesë, udhëzimi nuk pasqyron gjendjen faktike dhe kompleksitetin e procesit gjyqësor në Hagë

DITËN PJEŠËMARRËSE DHE PRIJËSE TË DEMONSTRATAVE, NË MBRËMJE NË ODA KËRKONIN FALJEN E GJAQEVE

Përballjen me mentalitetin patriarkal vajzat shqiptare, ish-të burgosura politike, veprimtare të pajtimit të gjaqeve, e kishin më të lehtë sesa kur përballeshin me dhunën dhe nënçmimin, në hetuesi, po ashtu mbi bazën patriarkale, të udbashëve, me qëllim për t'i dobësuar, vlarë moralisht dhe thyer

Lulëzim ETEMAJ



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

AKTUALE



SHQIPËRIA DHE ITALIA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJEN PËR NJOHJEN E PENSIONEVE F. 3

KUVENDI I ŠERBISË KONSTITUOHET MES FISHKËLLIMAVE E PANKARTAVE, OPOZITA BETOHET NË KORRIDOR F. 2

SHTYHET EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR KËMBIMIN E PRONAVE F. 3

EKONOMI



HAPET THIRRJA PËR SISTEMIN FOTOVOLTAIK PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VETËKONSUM F. 8

MINT NXJERR VENDIM PËR SHKËPUTJE TË KONTRATËS SË KONSUMATORËVE ME OPERATORËT KABLLORË F. 8

SPORT



PËRZGJIDHEN 42 BURSISTË 'SHPRESA OLIMPIKE 2024' F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030-500 878 | 045-500 878
044-500 878 | 049-500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Sulmohet edhe një anije në Detin e Kuq

LONDËR, 6 SHKURT - Një anije në Detin e Kuq u sulmua të martën nga një dron që dyshohet të jetë i grupit rebel jemenas, Huthi, thanë autoritetet. Sulmi ndodhi në perëndim të portit të Hodeidës dhe predha shkaktoi “dëmtim të lehtë” në dritaret e anijes në urë, thanë

Operacionet e Tregtisë Detare të Mbretërisë së Bashkuar. Një anije e vogël kishte qenë pranë anijes përpara sulmit, sipas autoriteteve britanike. Firma e sigurimit të anijeve, Ambrey, e identifikoi atë si një anije mallrash me flamurin e Barbadosit, në pronësi të Mbretërisë së Bashkuar.

“Askush nuk u lëndua në bordin e anijes, e cila pësoi vetëm ‘dëmtime të vogla’”, thuhet në njoftimin e kompanisë Ambrey. Më vonë, një zëdhënës ushtarak i rebelëve Huthi, grup i mbështetur nga Irani, Yahya Saree, tha në një deklaratë se forcat rebele

sulmuan dy anije të veçanta në Detin e Kuq, një amerikane dhe një britanike. Ai nuk dha asnjë provë për ta mbështetur këtë. Një nga anijet që Huthët pretenduan se e kishin sulmuar përputhej me detajet e dhëna nga Ambrey. Të dhënat e gjurmimit treguan se



ajo ishte në Detin e Kuq. Pronari i anijes tha për Associated Press se askush nuk u lëndua nga sulmi dhe se anija po vazhdonte për në Singapor.

Dy të vrarë dhe gjashtë të plagosur në sulmin ndaj gjykatës në Stamboll

STAMBOLL, 6 SHKURT - Dy persona u vranë derisa po përpiqeshin të sulmonin një gjykatë në Stamboll të martën, ka njoftuar ministri i Brendshëm turk, Ali Yerlikaya. Burri dhe gruaja u vranë gjatë një “përpjekjeje për të sulmuar” një pikë kontrolli të sigurisë në gjykatën e Caglayan në orën 11:46, ka shkruar Yerlikaya në mediet sociale. Gjashtë persona të tjerë mbetën të plagosur, në mesin e tyre tre policë. “U uroj shërim të shpejtë të plagosurve tanë”, tha ministri duke i përgëzuar policët të cilët i quajti heronj. Caglayan, i cili njihet si Pallati i Drejtësisë në Stamboll, është një kompleks i madh gjykatash



në rrethin Kagithane, në anën evropiane të qytetit. Yerlikaya më vonë i identifikoi

sulmuesit si anëtarë të Frontit Revolucionar për Çlirim, ose DHKP/C - grupi i cili nga Turqia

dhe Shtetet e Bashkuara konsiderohet organizatë terroriste. Sulmi ndodhi në ditën kur Turqia po përkujtonte përvjetorin e një tërmeti që vrau mijëra njerëz në jug të vendit. DHKP/C ka qenë kryesisht joaktive në vitet e fundit. Në mars të vitit 2015 grupi mori peng një prokuror duke kërkuar detaje për vrasjen e një adoleshenti nga policia gjatë protestave antikeveritare një vit më parë. Dy persona të armatosur vdiqën pasi policia hyri në ndërtesë, dhe prokurori vdiq më vonë si pasojë e plagëve.

Grupi, gjithashtu, mori përgjegjësinë për një sulm vetëvrasës me bombë në shkurt të vitit 2013, në Ambasadën e ShBA-së në Ankara, ku një roje e sigurisë u vra dhe katër persona të tjerë u plagosën. Muajin e kaluar një burrë u qëllua dhe u vra në një kishë të Stambollit në një sulm që u mor përsipër nga grupi militant, Shteti Islamik (IS). Dy burra u arrestuan më vonë si të dyshuar për vrasjen e Tuncer Cihan, 52 vjeç, më 28 janar, në kishën Santa Maria në lagjen Buyukdere. Dhjetëra anëtarë dhe mbështetës të dyshuar të IS-it, gjithashtu, u arrestuan.

Bideni thotë se do t’i vë veton një projektligji të veçantë për ndihma për Izraelin

UASHINGTON, 6 SHKURT - Administrata e presidentit Joe Biden ka njoftuar një ditë më parë se Bideni do t’i vendoste veton një propozimi për ndihmë për Izraelin, po jo për Ukrainën. Reagimi i Zyrës për Menaxhimin dhe Buxhetin i referohet propozimit për një projektligj të veçantë të mbështetur nga republikanët e Dhomës së Përfaqësuesve që do të ofronte ndihmë për Izraelin. Një projektligj më i gjerë ofron ndihmë për Ukrainën dhe Izraelin dhe siguron fonde të reja për sigurinë kufitare. “Administrata inkurajon me forcë të dyja dhomat

e Kongresit që ta refuzojnë këtë manovër politike dhe të dërgojnë me shpejtësi për nënshkrim Ligjin për Buxhetin Shtesë për Emergjencën të Sigurisë Kombëtare”, ka njoftuar kjo zyrë, raporton Reuters. Zyrtarët e administratës së presidentit demokrat po punojnë prej muajsh me demokratët dhe republikanët e Senatit mbi një paketë të bërë të njohur të dielën, që i lidh ndihmat urgjente prej miliarda dollarësh për Ukrainën, Izraelin dhe partnerët e ShBA-së në rajonin Indo-Paqësor, me ndryshime të politikës së

emigracionit. Udhëheqësit republikanë të Dhomës së Përfaqësuesve thanë para disa ditësh se ata do ta refuzonin projektligjin dy partiak të Senatit dhe në vend të tij, do të votonin për një projektligj që ofron ndihmë vetëm për Izraelin. Dhoma e Përfaqësuesve me shumicë republikane miratoi një projektligj vetëm për Izraelin në nëntor, por ai nuk u miratua në Senat. Një udhëhequr nga Demokratët, pasi anëtarët e tij po punonin mbi kërkesën e Bidenit që Kongresi ta miratonte paketën më të gjerë të sigurisë.



Kuvendi i Serbisë konstituohet mes fishkëllimave e pankartave, opozita betohet në korridor



BEOGRAD, 6 SHKURT - Seanca konstituive e Kuvendit të Serbisë, ku u konfirmuan mandatet e deputetëve të përbërjes së re, kaloi me fishkëllima nga opozita. Deputetët e opozitës ishin vendosur para foltores me pankarta ku shkruhej “I keni vjedhur zgjedhjet” dhe “Hajdutë, kthejini mandatet”. Lista e opozitës, Serbia kundër dhunës, pretendon se zgjedhjet

e dhjetorit ishin të parregullta, gjë që pushteti refuzon. Për shkak të akuzave për vjedhje zgjedhore, deputetët e koalicionit Serbia kundër dhunës e kanë bërë betimin në korridorin e Kuvendit dhe jo në sallë. Siç thanë ata, nuk kanë dashur ta bëjnë betimin me njerëz që kanë fituar mandate duke “vjedhur në zgjedhje”. Para tyre, këtë e kanë bërë

deputetët e koalicionit të djathtë Shpresa, i cili përbëhet nga Partia e Re Demokratike e Serbisë dhe Lëvizja për Rimëkëmbjen e Mbretërisë së Serbisë. Seanca konstituive e Kuvendit të Serbisë ka zgjatur rreth gjysmë ore. Gjatë asaj kohe vetëm janë konfirmuar mandatet, ndërsa deputetët kanë bërë betimin. Kryesuesi tha se do të njoftohen për vazhdimin e seancës.

Shtyhet ekzekutimi i vendimit të komunës së Prishtinës për këmbimin e pronave

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHKURT - Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - e ka aprovuar të bazuar kërkesën e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), ashtu që ka vendosur të shtyhet ekzekutimi i vendimit të Kuvendit të komunës së Prishtinës për këmbimin e pronës së kësaj komune në "Prishtina e re", me pronat në Zllatar.

Duke aprovuar kërkesën e IKD-së për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, gjykata vendosi se ky vendim nuk do të ekzekutohet deri kur gjykata të vendosë mbi meritat e këtij rasti.

Më 25 janar 2024 IKD-ja ka parashtruar padi, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, ndaj vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-20/04-236518/23, i datës 26.12.2023, për këmbimin e pronës komunale,

konkretisht parcelës kadastrale, nr. 01998-1, me sipërfaqe të përgjithshme 208318 m2 (Zona Kadastrale në Çagllavicë), dhe kalimin e kësaj prone në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit, me pronën, konkretisht parcelat kadastrale, nr. 00578-4, me sipërfaqe 3426 m2 (Zona Kadastrale Zllatar), me pronar Rrahman Haradinin dhe Shaban Konxhelin dhe kalimin e kësaj prone në pronësi të komunës së Prishtinës.

Gjykata gjeti se me propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, IKD-ja ka ofruar argumente të besueshme se në rastin konkret janë përmbushur në tërësi dhe në mënyrë kumulative të gjitha kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës, ashtu që ekzekutimi i këtij vendimi do të sillte dëm vështirë të riparueshëm.

Tutje, gjykata vlerësoi se shtyrja e ekzekutimit të këtij vendimi nuk është në kundërshtim me



interesin publik dhe as nuk i sjell dëm të madh palës kundërshtare apo personit të interesuar. Përkundrazi, gjykata gjeti se pikërisht shtyrja e ekzekutimit të vendimit paraqet interes publik. Kështu, gjykata gjeti se IKD-ja ka argumentuar mjaftueshëm

përmbushjen e kushteve ligjore për aprovimin e kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, derisa gjykata të vendosë përfundimisht lidhur me ligshmërinë e vendimit të kontestuar përkitazi me padinë e IKD-së.

Ndryshe, më 20 janar 2024, IKD-ja kishte reaguar ndaj vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës për këmbimin e pronës së kësaj komune në "Prishtina e re", me pronat në Zllatar, duke e cilësuar këtë vendim si të kundërligjshëm.

Shqipëria dhe Italia nënshkruajnë marrëveshje për njohjen e pensioneve

TIRANË, 6 SHKURT - Shqipëria dhe Italia kanë nënshkruar marrëveshjen për njohjen reciproke të sigurimeve shoqërore. Marrëveshja u nënshkrua në Romë nga ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Igli Hasani, dhe ai i Italisë, Antonio Tajani.

Dy kryediplomatët e cilësuan këtë marrëveshje si një moment të rëndësishëm për qytetarët e të dyja shteteve. "Finalizojmë sot 15 vjet përpjekje dhe shpreh mirënjohje për të gjithë ata që kanë kontribuar për këtë moment kaq të rëndësishëm", tha ministri Hasani. "Një marrëveshje e rëndësishme. Kishte 15 vjet që prisnim këtë firmë të cilën e formalizuar sot dhe garanton të drejtat e punonjësve italianë dhe punëtorëve shqiptarë në Itali", theksoi ministri i Jashtëm italian, Antonio Tajani.

Marrëveshja do të zbatohet për legjislacionet që lidhen me sigurimin për pleqërinë, invaliditetin, pensionin familjar, sigurimin për përfitimin për



sëmundjet, barrëldjen dhe sigurimin e papunësisë. Sipas Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë, nga vlerësimi paraprake rezultoi se fillimisht do të përfitojnë 4 000 pensionistët, për të vijuar më pas në rritje vit pas viti. Një nga përfitimet kryesore është bashkimi i periudhave kontributive. Konkretisht periudhat e sigurimit (vullnetar

dhe të detyrueshëm) të plotësuara sipas legjislacionit të secilit shtet grumbullohen dhe bashkohen me periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, me kusht që ato të mos mbivendosen dhe sipas dispozitave të parashikuara nga legjislacioni i secilit shtet. Të dhënat e institucioneve shqiptare flasin për rreth 300 000

shtetas shqiptarë me qëndrim të rregullt në Itali dhe që japin kontribute shoqërore.

Vitet e fundit ka pasur disa herë protesta nga qytetarë shqiptarë që kanë punuar në Itali, të cilët kanë kërkuar njohjen e viteve të punës dhe kontributeve shoqërore në mënyrë që të përfitonin pension. Protesta e fundit është mbajtur në gusht të vitit para ambasadës italiane. Gjatë asaj proteste, ambasadori italian në Shqipëri, Fabrizio Bucci, doli dhe i takoi protestuesit, duke premtuar nënshkrim të shpejtë të marrëveshjes.

Shqipëria dhe Italia përfunduan negociimin teknik të marrëveshjes për pensionet më 26 korrik të 2022, por marrëveshja u finalizua vetëm më 6 shkurt 2024. Pas nënshkrimit, tani marrëveshja duhet të ratifikohet nga të dyja shtetet dhe më pas të hyjë në fuqi.

Në një konferencë për medie, ministri Hasani u pyet nga gazetarët nëse nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ishte një

"shpërblim" për marrëveshjen që Shqipëria ka firmosur me Italinë për strehimin e emigrantëve, por ai tha se nuk ka asnjë lidhje mes tyre. Hasani theksoi se marrëveshja për pensionet vjen pas shumë negociatash dhe diskutimesh.

Përveç Italisë, Shqipëria ka 16 marrëveshje të nënshkruara për njohjen e sigurimeve shoqërore me disa shtete si: Austria, Belgjika, Çekia, Gjermania, Hungaria, Kanadaja, Kosova, Luksemburgu, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Turqia, Zvicra, Bullgaria, Kroacia.

Ndërkaq 17 marrëveshje janë në proces negociimi. Konkretisht me Greqinë, Danimarkën, Holandën, Shtetet e Bashkuara, Poloninë, Serbinë, Spanjën, Mbretërinë e Bashkuar, Moldavinë, Slloveninë, Australinë, Francën, Suedinë, Norvegjinë, Islandën, Finlandën dhe Emirateve të Bashkuara Arabe. Ndërsa në proces vlerësimi janë tri marrëveshje me Indinë, Izraelin dhe Arabinë Saudite.

Latifi takon punonjësit e administratës, kërkon respektimin e orarit të punës

RAHOVEC, 6 SHKURT - Në sallën e Kuvendit Komunal të Rahovecit, kryetari Smajl Latifi, nën shoqërimin e nënkryetarit Iska, të drejtorit të Administratës, Besnik Hotit dhe të drejtorëve të drejtorive komunale, ka mbajtur takimin e parë të rregullt me punonjësit e administratës komunale. Fillimisht, ai i ka falënderuar të gjithë punonjësit për angazhimet dhe bashkëpunimin në

përputhje me detyrimet e parapara me ligj. Latifi ka theksuar edhe një herë rëndësinë e respektimit të orarit të punës dhe punonjësit të kenë përkushtim të përzgjedhshëm për kryerjen e shërbimeve për qytetarë, duke ngritur gjithnjë e më shumë cilësinë e punës, për t'i bërë sa më të lehta dhe efikase shërbimet administrative. Nga zyrtarët komunalë, kryetari

Latifi ka kërkuar angazhim maksimal për ta mbajtur Rahovecin sa më lart në transparencë, performancë komunale, investime publike dhe në realizimin e të hyrave. Më pas, për lansimin e sistemit të hyrje-daljeve në punë, u. d. udhëheqësi i Zyrës së Personelit, Agron Thaqi, shpjegoi funksionimin e këtij sistemi, si dhe dha sqarimet e nevojshme.



LIDERËT E UÇK-së NË PRILL TË VITIT 2023 KËRKUAN NDRYSHIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV PËR KOMPENSIMIN E EKIPEVE MBROJTËSE

Liderët e UÇK-së alarmuan institucionet se po rrezikohet mbrojtja e tyre

- Udhëzimin Administrativ nuk reflekton kostot aktuale të mbrojtjes.
Po rrezikohet mbrojtja efikase dhe efektive në rastin e liderëve të UÇK-së

Avokati i Hashim Thaçit, Gregory Kehoe, së bashku me ekipin e tij, në fund të muajit janar ka parashtruar kërkesë që të tërhiqet nga mbrojtja e ish-presidentit për shkak të moskryerjes së obligimeve financiare. Lidhur me vështirësitë financiare, liderët e UÇK-së në prill të vitit 2023 i janë drejtuar me një kërkesë Ministrisë së Drejtësisë për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ, i cili parasheh kompensimin e ekipeve mbrojtëse. Në këtë kërkesë, avokatët, në emër të Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, kanë vlerësuar se udhëzimi aktual administrativ është duke e rrezikuar mbrojtjen e katërsjes së UÇK-së. Sipas kësaj kërkesë, udhëzimi nuk pasqyron gjendjen faktike dhe kompleksitetin e procesit gjyqësor në Hagë

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 6 SHKURT - Gregory Kehoe dhe ekipi i tij nga kompania "Greenberg Legal Associates" para disa ditësh kanë kërkuar të tërhiqen nga mbrojtja e ish-presidentit Hashim Thaçi në rastin e tij në Gjykatën Speciale. Kjo kërkesë ka ndodhur për shkak të moskryerjes së obligimeve financiare.

Në fund të muajit janar të këtij viti, vëllai i ish-presidentit Hashim Thaçi, Idrizi, ka sqaruar se kontrata me kompaninë ligjore "Greenberg Legal Associates" nuk është vazhduar në vitin 2024 për shkak të vështirësive financiare për mbulimin e kostos së të gjithë avokatëve të angazhuar si pjesë e mbrojtjes së Thaçit.

Pas këtij zhvillimi ka reaguar Ministria e Drejtësisë (MD), e cila është përgjegjëse për kompensimin e ekipeve mbrojtëse në rastin e liderëve të UÇK-së dhe të tjerëve. "Në përputhje me Udhëzimin Administrativ numër 08/2022 për mbrojtjen juridike të personave të akuzuar potencialë për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, Ministria e Drejtësisë ka lidhur marrëveshje për përfaqësim me avokatët përkatës të personave të akuzuar, në këtë rast, me mbrojtjen e z. Hashim Thaçi, për të cilin rast, raportohet tërheqja e mbrojtjes për shkak të mosrealizimit të pagesave. Në përputhje me udhëzimin dhe marrëveshjen e tillë (legjislacionin në fuqi), Ministria e Drejtësisë ka kryer të gjitha obligimet lidhur me pagesën apo kompensimin e mbrojtjes së z. Hashim Thaçi", ka njoftuar MD-ja, duke shtuar se kjo ministri kryen pagesa vetëm me avokatët me të cilët ka

marrëveshje, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë ka thënë se ka marrëveshje me avokatët e Hashim Thaçit, Luka Misiq.

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së kërkon ndryshimin e udhëzimit: Po rrezikohet mbrojtja

Duke iu referuar procesit gjyqësor në Gjykatën Speciale në Hagë dhe vështirësive për mbulimin e shpenzimeve për ekipet mbrojtëse, avokatët e katër liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, në emër të katërsjes çlirimtare i kanë bërë kërkesë Ministrisë së Drejtësisë që të ndryshohet dhe plotësohet Udhëzimi Administrativ nr. 08/2022, i cili parashihet tarifa të reja për avokatët dhe shpenzimet e tjera për mbrojtjen juridike të të akuzuarve në proceset gjyqësore pranë Gjykatës Speciale.

Kërkesa e liderëve të UÇK-së për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ, të cilën e ka siguruar "Epoka e re", ishte bërë më 24 prill të vitit 2023. Sipas kësaj kërkesë, udhëzimi aktual administrativ është duke paraqitur vështirësi për mbrojtje adekuate sa iu përket të akuzuarve të cilët po mbahen në paraburgim nga Gjykata Speciale. "Katër të akuzuarit shprehin shqetësimin e tyre se tavanet në tarifat e avokatëve dhe shpenzimet e tjera të prezantuar rishitazi në Udhëzimin Administrativ nr. 08/2022 nuk reflektojnë kostot aktuale që mbrojtja pëson në këto raste. Për rrjedhojë, mundësia që katër të akuzuarit të realizojnë një mbrojtje efikase dhe efektive është në rrezik. Me udhëzime



bashkërisht nga katër të akuzuarit, po ju paraqesim një kërkesë për rritjen e tarifave të avokatëve dhe shpenzimet e tjera për kompensim për arsyet si në vijim. Që në fillim duam t'i shprehim shqetësimet tona sa i përket mënyrës dhe metodës së kalkulimit të shumave ligjore sipas Udhëzimit Administrativ nr. 08/2022. Ndonëse e respektojmë obligimin e organeve publike si Ministria e Drejtësisë për t'u kujdesur për fondet publike, theksojmë, gjithashtu, se ministria duhet të kujdeset për fondet publike në një mënyrë që nuk rrezikon mbrojtjen e katër të akuzuarve në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara", është thënë në kërkesën e katër liderëve të UÇK-së, e cila mban nënshkrimin e avokatëve të tyre. Sipas kësaj kërkesë, Udhëzimi Administrativ nuk pasqyron gjendjen faktike për mbrojtje efektive të liderëve të UÇK-së. "Ne kemi vënë re se Udhëzimi Administrativ nr. 08/2022 paraqet një sërë anomalish në lidhje me tarifat për mbrojtjen juridike dhe shpenzimet e tjera të cilat jo vetëm se nuk pasqyrojnë kostot ekonomike për mbrojtjen e rasteve të madhësisë dhe rëndësisë së tillë por, mbi të gjitha, nuk përputhen me disa nga dispozitat e tjera të Udhëzimit Administrativ apo me praktikën e vendeve të tjera të rajonit. Për shembull, Udhëzimi Administrativ nr. 08/2022 prezanton një skemë të re

kompensimi ku shumat përcaktohet nga një sërë faktorësh të listuar në aktin nënligjor. Së pari, shumat për kompensim varet nga faza e procedurave. Faktori vendimtar në përcaktimin e shumës për kompensim ndërlidhet me kompleksitetin e rastit, duke filluar me kompleksitetin 'të lehtë' për ato të cilësuar si kompleksiteti 1, e deri tek 'shumë e vështirë' për rastet e kompleksitetit 4. Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 08/2022, komisioni merr parasysh një sërë faktorësh kur përcakton kompleksitetin e një rasti, duke përfshirë këtu por pa u limituar në pozitën e pretenduar e të akuzuarit në hierarkinë politike ose ushtarake; numrin dhe natyrën e akuzave në aktakuzë; numrin dhe llojin e dëshmitarëve dhe dokumenteve të çështjes; shtrirjen gjeografike të krimeve të pretenduara në aktakuzë; nëse çështja ngre aspekte të reja apo kompleksitetin e argumenteve ligjore dhe faktike të çështjes. Pra, sa më kompleks të jetë rasti, aq më shumë burime njerëzore dhe materiale nevojiten për të siguruar një mbrojtje adekuate dhe profesionale. Për sa më sipër, Udhëzimi Administrativ nr. 08/2022 parasheh se për një rast të kompleksitetit 4 (pra, rasti më i vështirë), ekipi mbrojtës i të akuzuarit duhet të ketë të paktën 12 anëtarë", është thënë në këtë kërkesë. Më tutje, në këtë kërkesë është

përmendur rasti i ish-presidentit Hashim Thaçi, i cili, sipas avokatëve, përmbush të gjitha kriteret për mbështetje institucionale.

Në këtë kërkesë janë bërë edhe disa krahasime me rastet e mëhershme që kanë ndodhur në Tribunalin e Hagës. Në krahasim me rastet e tjera është përmendur numri i dëshmitarëve të prokurorisë, i cili kalon mbi 300 dëshmitarë. "Siç jeni në dijeni, rasti Hashim Thaçi et al. ka hyrë tashmë në fazën e gjyqimit. Është kërkuar që qartë se rasti në fjalë përmbush të gjitha kriteret e listuara për 'Kompleksitetin 4' sipas Udhëzimit Administrativ nr. 08/2022. Në fakt, mjafton që ta shikoni numrin e dëshmitarëve që prokuroria synon të thërrasë për ta përcaktuar kompleksitetin dhe madhësinë e rastit. Aktualisht, lista e dëshmitarëve të prokurorisë përfshin 312 dëshmitarë, numër ky që ndjeshëm kalon numrin e dëshmitarëve që prokuroria kishte thirrur në raste të ngjashme pranë Tribunalit Ndërkombëtar Penal për Ish-Jugosllavinë (TNPJ). Për më tepër, aktakuza e ndryshuar shtrihet për një periudhë prej 1 viti e gjysmë dhe ngarkon të katër akuzuarit me shtatë vepra për krime kundër njerëzimit dhe katër vepra për krime lufte", është thënë në kërkesën drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

Në këtë kërkesë është elaboruar edhe afati kohor kur ka ndodhur

ROLI I ISH-TË BURGOSURAVE POLITIKE NË LËVIZJEN E PAJTIMIT TË GJAQEVER 1990-1991 NË KOSOVË (3)

Ditën pjesëmarrëse dhe prijëse të demonstratave, në mbrëmje në oda kërkonin faljen e gjaqeve

Përballjen me mentalitetin patriarkal vajzat shqiptare, ish-të burgosura politike, veprimtare të pajtimit të gjaqeve, e kishin më të lehtë sesa kur përballeshin me dhunën dhe nënçmimin, në hetuesi, po ashtu mbi bazën patriarkale, të udbashëve, me qëllim për t'i dobësuar, vrarë moralisht dhe thyer



Lulëzim ETEMAJ

Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë, si një lëvizje unike në historinë e popullit shqiptar, në raport me vajzën/gruan shqiptare, dëshmoi se për të hyrë në odë, kërkuar faljen e gjakut dhe shtrirë dorën e pajtimit; drejtimin e tubimeve të pajtimit dhe kuvendeve të saj, të qenit vajzë/grua jo vetëm që nuk ishte më një e metë, por ishte përparësi e veçantë. Posaçërisht kur bëhet fjalë për ish-të


burgosurat politike (18). Aq më tepër kur ato shpesh gjatë ditës ishin pjesëmarrëse dhe prijëse të demonstratave nëpër qytete të ndryshme të Kosovës, ndërsa në mbrëmje trokitnin derë më derë te familjet e shumta për të kërkuar prej tyre faljen e gjakut dhe shtrirjen e dorës së pajtimit. Respekti i madh i treguar ndaj tyre, sidomos mirëpritja e tyre kur vepronin në vendbanime dhe territore të tjera të Kosovës, si nga Peja në Rahovec, Drenas, Tetovë, Gostivar, Gjilan, Prizren, Gjakovë, Llap, është një karakteristikë

tjetër e nderimit dhe përkrahjes që ato e kanë gjetur në mesin e familjeve të shumta shqiptare (19). E kuptueshme, sado që rrallë, të papërfillshme në numër, si pasojë e pikëpamjeve patriarkale, ka pasur edhe shfaqje të shikimeve ndër vetulla, posaçërisht kur ato kanë hyrë në oda, përfshirë edhe refuzimin për t'ua lejuar hyrjen brenda. Një rast i tillë është regjistruar në fshatin Zatriq të komunës së Rahovecit, kur i zoti i odës ka tentuar t'ia ndalojë Zogë Shalës hyrjen brenda, duke

insistuar ta çojë atë atje ku rrinin gratë. "Shko ti te gratë, se nuk është oda për gra", i ishte drejtuar ai Zogë Shalës. Reagimi i bashkëveprimtarëve Lulëzim Etemaj dhe Begzad Gashi, si dhe shpjegimi i tyre këmbëngulës se ajo jo vetëm që duhet të hyjë në odë, por për sontë edhe e ka fjalën kryesore dhe se do ta ulim në ballë të oxhakut, ka bërë që të hapet dera edhe për të (20). Për befasinë e këndshme të të gjithëve, edhe të disa burrave të fshatit që kishin

ardhur në odë, i zoti i odës, pasi që flasin disa nga bashkëveprimtarët e saj, duke ndrojtur që do t'i ketë ngelur hatri, i drejtohet Zogë Shalës me këto fjalë përplot njerëzi: "Ti që erdhe dhe hyre në odën time, pse s'e fole ende as edhe një fjalë?". Pasi e falënderon me dashamirësi mikpritësin, ajo i bën një shpjegim përmbajtjesor rëndësisë së zhdukjes së gjakmarrjes si dhe i kërkon të zotit të odës që t'ia falë gjakun rinisë së Kosovës, të ardhmes së saj më të mirë. Plaku ngrehet në këmbë

Si mund të dilet nga kjo krizë?



Shkruan: Milazim KRASNIQI

Jemi rrasë fjalë nga ambasadorë, ministra e ernisarë që venë e vijnë në Kosovë “si korpat e Zveçanit”. Njëri i bie thumbit, tjetri patkoit. Siç dihet, ka raste të shumta kur diplomatët e huaj e ushqejnë një krizë, sepse kanë interesa të kundërvëna. Rrjedhimisht as nuk është rastësi që Kosova i ka punët keq si në planin ndërkombëtar, ashtu edhe në atë të brendshëm. I ka sepse ka deficit të lidërshiptit të vet. Po të kishim lidërshipt të vërtetë qeverisë dhe politikë mirëfilli

shtetërore, zgjidhja do të mund bëhej me disa poteza, duke ua imponuar iniciativën tonë edhe të huajve. Ja si do të duhej të lëvizet drejt zgjidhjes së problemeve konkrete!

1. Dorëheqja momentale e katër kryetarëve të komunave në veri, shpallja e mbajtja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në ato komuna.
2. Dërgimi i menjëhershëm i draft-statutit nga ana e qeverisë në Gjykatën Kushtetuese dhe harmonizimi e pastaj miratimi i tij

nga qeveria.

3. Zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese për manastirin e Deçanit, në pako me rregullimin e statusit të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë me një Marrëveshje Themeltare (Temeljni ugovor) të qeverisë së Kosovës me KOS (jo me qeverinë e Serbisë.)

4. Nëse qeveria Kurti nuk ka guxim që të marrë këso vendimesh, gjë që po duket sheshazhi, mund të formohet një qeveri e koalicionit të gjerë, vetëm për ta përmbyll nga ana

e Kosovës këtë proces. (Në variantin e skajshëm mund të thirret një Asamble Kushtetuese, me mandat për ta mbyll këtë proces)

5. Pastaj me një akord të të gjithë akterëve mund të shkohet në zgjedhje të përgjithshme. Konkludim: e sigurt është që statu quoja nuk i konvenon Kosovës, sepse Kosova është nën masat e BE-së dhe nën qortim e presion të sponsorëve të saj, pa asnjë gjasë që të pranohet në OKB. Ndërsa Serbia është amnestuar edhe për sulmin

në Banjaskë dhe për politikën rusofile. Ky është një realitet absurd i llojit të vet, prandaj do të duhej të gjendej rruga që të dilet nga kjo situatë absurde. Nga kjo gjendje dilet vetëm me vendime të forta, të guximshme e me efekte strategjike. Jo me poteza me qëllime populiste, të cilat që të nesërmen kthehen kundër Kosovës, siç u kthye puna e targave, e inaugurimit të kryetarëve të komunave, e bastisjeve të marketeve e barnatoreve dhe e dinarit.

dhe i drejtohet sërish asaj: “Unë gjakun do ta fal ty, Kosovës, popullit të Kosovës. Të qoftë fal gjaku!”.

“Bija ime, dëgjo çka po të them: Sa herë që ti do të vish në komunën tonë, dyert e shtëpisë sime i ke të hapura. Do të jesh si bijat e mia, sepse këtij konaku iu shtua edhe një bijë”, janë këto fjalë, të pikura nga zemra, me të cilat ky zemërbardhë, së bashku me gjakun e falur, e përcolli përtej dyerve të oborrit Zogë Shalën. Përballjen me mentalitetin patriarkal, vajzat shqiptare, ish-të burgosura politike, veprimtare të pajtimit të gjaqeve, e kishin më të lehtë sesa kur përballëshin me dhunën dhe nënçmimin, në hetuesi, po ashtu mbi bazën patriarkale, të udbashëve, me qëllim për t'i dobësuar, vrarë moralisht dhe thyer. Ashtu si në rastin e parë, përballë udbashëve, edhe në rastin e dytë ishin të fokusuara në qëllimin e tyre final. Ato tashmë kishin përkrah edhe bashkëveprimtarët. Nuk ishin të vetmuara në betejën e tyre kundër patriarkalizmit. Me të drejtë ndiheshin edhe të privileguara për mirëkuptimin që gjenin si ish-të burgosura politike ndër familjet që shtrinin dorën e pajtimit në emër të rinisë së Kosovës, pjesë e së cilës ishin edhe ato (21).

Përmbyllje

Vajzat shqiptare, ish-të burgosura politike, mirëkuptimin dhe përkrahjen fillimisht e kishin gjetur në shtëpitë e tyre. Kjo atyre u kishte dhënë forcë dhe motiv shtesë në përpjekjen që këtë ta arrijnë edhe nga familjet e dëmtuara, të kuvendojnë me to dhe t'i bindin për t'i falur në mënyrë vullnetare, pa asnjë kusht apo kompensim, në emër të rinisë, gjakut të derdhur në demonstrata, flamurit dhe Kosovës, të gjitha gjaqet, plagët dhe ngatërresat. Ato jo vetëm që gjetën përkrahje dhe morën dorën e pajtimit, por insistuan që në aktin e faljes të përfshihen edhe vajzat dhe gratë e shtëpisë së dëmtuar, nëna, motra, bashkëshortja, e bija. Prandaj, vajza dhe grua shqiptare, edhe në këtë aspekt, i tejkaloi të gjitha rregullat dhe praktikën që përgjatë historisë së popullit shqiptar e kanë shoqëruar faljen e gjaqeve. Ato gjetën forcë shpirtërore, e mundën së pari dhembjen, më pastaj edhe çdo paragjykim mbi bazën patriarkale dhe vendosën vetë ta falin gjakun. E bënë këtë, por jo vetëm kur nuk kishte asnjë burrë në shtëpi, siç ishte rasti i Sankocit të Drenicës, ku motra e madhe, nga pesë sa kishin mbetur, Hyra, e bindur nga fjala e

rinisë, e fal gjakun e babait. Vajza dhe grua shqiptare e falën gjakun edhe kur shtëpia kishte burra, siç ishte rasti i një nëne fisnike në Prizren, që e thërrisnin nëna Zojë, e cila fali gjakun e të birit (22); nëna Sabile (Sfishta) në Prishtinë, që e fali gjakun e dy djemve; Lima (Konushheci) nga Llugat e Besianës, që e fali gjakun e burrit dhe të vajzës (23), apo nëna Nuriye (Kunraj) nga fshati Zllapek i Pejës e cila nuk pret të flasë në telefon me djemtë në Gjermani, sepse “ata janë djemtë e mi dhe nuk mund të mendojnë ndryshe”, u kishte thënë të rinjve dhe ua kishte falur gjakun Zogë Shalës, Myrvete Dreshajt dhe Have Shalës (24). Ndërsa, një grua tjetër, në Studenicë të Istogut, u thotë pikëllueshëm dhe me përzemërsi të madhe Myrvete Dreshajt, Zogë Shalës e Brahim Dreshajt: “Unë gjakun e burrit do t’jua fal, por ç’të bëj se ju s’do të vini më, dhe mua do t’më marrë malli për ju!” (25).

Kështu, vajzat shqiptare, ish-të burgosura politike, u bënë edhe nxitëse të emancipimit dhe kycjes jo vetëm në faljen e gjaqeve, por edhe në veprimtari të tjera shoqërore edhe të shumë vajzave dhe grave të tjera.

Sipas të dhënave aktuale, numri i pajtimeve të arritura nga Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve 1990-1991 në

Kosovë është 2 511. Prej këtyre, 1 169 janë gjaqe, 477 plagë, ndërsa 865 është numri i ngatërresave (26). Këta numra të akteve të larta fisnike janë vetëm një nga segmentet e suksesit të saj shumëdimensional, filluar nga aspekti socio-ekonomik, kulturor, human, e deri tek ai kombëtar, duke qenë se si asnjë organizatë tjetër ajo ia arriti ta bashkojë popullin shqiptar. Pa këtë bashkim paraprak, të arritur nga Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë, sfidat e shumta që solli lufta çlirimtare kundër Serbisë do të ishin më të rënda.

- (1) Shtjefën Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kuvendi, mungon vendi dhe viti i botimit, faqe 85.
- (2) Po aty, faqe 85.
- (3) Po aty, faqe 85.
- (4) Shtjefën Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kuvendi, mungon vendi dhe viti i botimit, faqe 90.
- (5) Anton Çetta, Brezat që vijnë, pa plagë të vjetra, intervistë në Fjala, nr. 20, shtator 1990, faqe 30.
- (6) Sabile Keçmezi-Basha, Të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë 1945-1990, Logos-A, Shkup, 2009, faqe 229.
- (7) Kadri Halimi, Shkëndijë e lirisë, Zëri i Kosovës, nr. 22, 30 maj 1996, faqe 10.
- (8) Anton Çetta, Gjaqet po i falen rinisë, intervistë në Zëri i rinisë, 7 prill 1990, faqe 18.
- (9) Lulëzim Etemaj, Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë,

- Armagedoni, Prishtinë, 2020, faqe 55-56.
- (10) Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktakuzë, Pn r. 60/85, dt. 30.5.1985
- (11) Ceremonia e shprehjes së ngushëllimeve
- (12) Gazeta Zëri i Kosovës, nr. 2, shkurt 1990, faqe 1.
- (13) Nismëtarët e Aksionit për Pajtimin e Gjaqeve, Kosovë i konsideronin të gjitha trojet shqiptare të shkëputura nga Shqipëria dhe të mbetura nën pushtimin e Jugosllavisë.
- (14) Zogë Shala, deklaratë me shkrim dhënë autorit, 11 mars 2021.
- (15) Fikrije Musa, deklaratë me shkrim dhënë autorit, 25 mars 2021.
- (16) Lumniye Azemi-Mrina, deklaratë me shkrim dhënë autorit, 26 maj 2021.
- (17) Procesverbali i Kuvendit I, Strellc, 19 maj 1990, faqe 8.
- (18) Nafije Zendeli, deklaratë me shkrim dhënë autorit, 19 mars 2021.
- (19) Po aty
- (20) Zogë Shala, deklaratë me shkrim dhënë autorit, 11 mars 2021.
- (21) Po aty
- (22) Anton Çetta, Gjaqet po i falen rinisë, intervistë në Zëri i rinisë, 7 prill 1990, faqe 18.
- (23) Fatmir Brajshori, veprimtar i pajtimit të gjaqeve në Prishtinë, deklaratë me shkrim dhënë autorit, 10 prill 2021.
- (24) Zogë Shala, deklaratë me shkrim dhënë autorit, 11 mars 2021.
- (25) Pajtimi i gjaqeve 1990-1991, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1999, faqe 233.
- (26) Po aty, faqe 9-224.

(FUND)

KEDS-i dorëzoi në gjykata 2 317 raste për vjedhje të rrymës, po i fiton 100 për qind të rasteve

PRISHTINË, 6 SHKURT - Gjatë vitit 2023 KEDS-i ka dorëzuar në gjykatat përkatëse të Republikës së Kosovës 2 317 lëndë kundër keqpërdorimit të energjisë elektrike.

Të gjitha rastet e shqyrtuara deri tash janë fituar nga kompania. Ndërkaq, pjesa tjetër pritet të shqyrtohen këtë vit. “Përmes luftimit të fenomenit të keqpërdorimit të energjisë elektrike në forma ligjore, KEDS jo vetëm se po mbron infrastrukturën energjetike, por po shpreh edhe vendosmërinë dhe qëndrimin e kompanisë

kundër praktikave të paligjshme që rrezikojnë sigurinë dhe stabilitetin e rrjetit elektrik. Keqpërdorimi i energjisë elektrike hyn në kuadër të ‘Vjedhjes së shërbimeve’, i cili sipas nenit 314 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale dhe, si i tillë, është i dënueshëm deri në tri vjet burg”, ka njoftuar KEDS-i.

Përmes fushatës “Rryma t’kushton ma lirë”, KEDS-i ka bërë me dije se vazhdimisht po e informon opinionin e gjerë



publik për pasojat që mund t'i ketë kushdo që e keqpërdor energjinë elektrike. “KEDS-i mbetet i përkushtuar të luftojë

keqpërdorimin e energjisë elektrike, jo vetëm për të zvogëluar humbjet në rrjet, por edhe për të mbrojtur interesat e

konsumatorëve të ndërgjegjshëm, sepse vjedhja e energjisë elektrike, ndër të tjera, cenon edhe sigurinë e të tjerëve dhe pronave përreth. Si i tillë, KEDS-i po vazhdon me kontrolle të shumta në baza ditore në mbarë Kosovën. Përgjatë periudhës janar - dhjetor 2023, ekipet e kontrollit kanë realizuar gati 100 000 kontrolle te konsumatorët e dyshimtë për keqpërdorim të energjisë elektrike, prej të cilëve 6,710 janë identifikuar si keqpërdorues”, ka njoftuar KEDS-i.

Hapet thirrja për sistemin fotovoltaiik për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 SHKURT - Ministria e Ekonomisë ka hapur thirrjen publike për mbështetjen e konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për investim në sisteme të energjisë së ripërtëritshme - sistemi fotovoltaiik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum, të financuara nga Bashkimi Evropian (BE).

Instalimi i sistemeve të energjisë së ripërtëritshme - sistemi fotovoltaiik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum për konsumatorët familjarë.

Vlera e subvencionit për konsumatorët familjarë mbulon shumën 250 euro/kWp dhe deri në 1750.00 euro, subvencionohet vetëm një sistem fotovoltaiik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum për një shtëpi, sistemi duhet të blihet i ri. Data e blerjes duhet të jetë nga data e shpalljes së thirrjes, e cila fillon më 6 shkurt 2024. Aplikimi për subvencionim është i ndarë në dy faza dhe në të dy fazat aplikimi bëhet online përmes platformës e-Kosova.

Në këtë ngjarje së bashku me kryeministrin Albin Kurti ishin edhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe



Tregtisë, Rozeta Hajdari.

Në fjalën hyrëse të tij, kryeministri Kurti tha se: “Ky sukses në këtë hap të procesit sigurisht që nuk vjen rastësisht. Ai është rezultat i përpjekjeve tona për ta rritur transparencën e për ta

përmirësuar mjedisin e të bërit biznes dhe të investuarit në ekonominë e vendit tonë”.

Ai ka treguar se me anë të kësaj skeme familjet do të mund të aplikojnë për mbështetje për sisteme diellore me kapacitet prej

3 deri në 7 kilovatë, për çka do të subvencionohen 250 euro për kilovat, deri në 1750 euro në total, dhe me këtë rast familjet e bizneset e kanë më të lehtë për të bërë zgjidhje të qëndrueshme dhe më të përballueshme për ta. “Për

instalimin e sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar, që nga mesi i këtij muaji, bizneset do të mund të subvencionohen 40 % të vlerës, deri në 4 000 euro. Për familjet kjo masë është zbatuar në fund të vitit të kaluar. Për të dy këto masa bizneset në pronësi apo në bashkëpronësi të grave mbi 51 % do të subvencionohen me 200 euro shtesë”, u shpreh kryeministri.

Duke theksuar se lansimi i sotëm është në përputhje të plotë me qëllimet tona të përbashkëta dhe afatgjatë për sektorin e energjisë, ai përfundoi se “Kosova qëndron krahas shteteve partnere evropiane në përpilimin dhe zbatimin e strategjive dhe në zhvillimin e miratimit dhe politikave të cilat në thelb e synojnë një sektor të energjisë që është edhe i qëndrueshëm, edhe i diversifikuar, edhe i pastër, e që gjithnjë e ka në qendër qytetarin e Republikës”.

Ndërkaq, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, veçoi se përfitimet që kanë qytetarët, bizneset e vendi ynë nga investime të tilla janë të shumëllojshme, duke filluar nga eficientia e energjisë, ulja e ndotjes, ulja e faturave të energjisë dhe që qytetarët të jenë pjesëmarrës aktivë, në qendër të zhvillimeve dhe të përfitimit të ndryshimeve që vijnë me tranzicionin energjetik.

MINT nxjerr vendim për shkëputje të kontratës së konsumatorëve me operatorët kabllorë

PRISHTINË, 6 SHKURT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përmes Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT), pas shqyrtimit të qindra ankesave të konsumatorëve që ka pranuar Departamenti i Mbrojtjes së Konsumatorit, lidhur me shërbimet e rrjetit kabllor, ka nxjerrë vendim me të cilin ka obliguar operatorët kabllorë t'i largojnë kushtet e padrejta në kontratë, duke ua lejuar konsumatorëve të drejtën për shkëputje të kontratës, nëse operatori nuk

ka arritur t'i përmbush obligimet sipas kontratës. “Detyrimi që iu është vënë konsumatorëve me rastin e lidhjes së kontratës për të paguar pjesën e mbetur të kontratës edhe nëse ka ndryshuar përmbajtja e shërbimit/ kanaleve, është në kundërshtim me nenin 72, paragrafi 1, nën paragrafi 1.15 i Ligjit nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, ku specifikohet që ‘Kushtet të cilat konsiderohen si të padrejta janë ato kushte të cilat kanë qëllimin apo efektin e:

Detyrimit të konsumatorit që të përmbushë të gjitha detyrimet e tij kur shitësi ose furnizuesi nuk i përmbush obligimet e tij’. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë mbetet e përkushtuar për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë konsumatorëve, prandaj me këtë rast i falënderon për besimin që ata tregojnë, duke i dërguar të gjitha ankesat e tyre pranë Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit në kuadër të MINT, për shqyrtim të mëtejshëm nga Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së



Tregut dhe institucionet tjera përgjegjëse, me trajtimin me kujdes të secilës ankesë që vjen

nga qytetarët, përkatësisht konsumatorët”, ka njoftuar MINT.

PËRMBARIM RAMA



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Përparimi apo Ostap Benderi i Prishtinës: Në zgjedhjet e fundit lokale në Prishtinë u bë një garë interesante dhe kryetar u zgjodh londinezi i Gollakut, Përparim Rama. Ishte befasi mënyra e paketimit të personalitetit të Ramës për votuesit e kryeqytetit; arkitekt i njohur i përmasave botërore, milioner (duket vetëm me rruaza të kuqe të gjakut), emër i respektuar i cili po e lë jetën në Londër për t'u kthyer në Prishtinë dhe, si arkitekt i "shquar", të vendosë një rregull në këtë Hiroshimë arkitektonike. Krijohet përshtypja e rreme se Përparim Rama ka vepruar si profesorët e shquar çifutë që lanë katedrën e Oksfordit, Kembrixhit, Jejlit, Masaçusetit, Palo Alto etj. për të dhënë mësim në shkollat në fshatra të largëta në Izrael, në vitin 1948 kur u formua ky shtet me deklaratën e Lordit Bolfur. U paketua si kandidat i LDK-së për faktin se kjo parti nuk kishte tjetër kandidat, kurse kryetari aktual i saj që e mori partinë, pa e derdhur as një pikë djerse, kishte plane më të mëdha, kapjen e partisë, si noter i Vojsa Osmanit që e ndau këtë parti në dy pjesë. Vetë Përparim Rama, si ruajtës dhe mirëmbajtës i Katedrales së Prishtinës, thuja në çdo intervistë distancohej nga LDK-ja, duke thënë se nuk është anëtar i kësaj partie derisa ia ngrehën veshët, Lumi i Xhikës, me mercenarët e gjithmonshëm që mbijetuan çdo kryetar të LDK-së. Si arkitekt i shquar propozoi plane që as buxheti i Londrës nuk do të ishte në gjendje t'i përballojë. VV-ja ishte një parti që theu rekordin e votave të fituara në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021 prandaj zgjedhjen e kryetarit që e kishte propozuar e konsideronte si çështje teknike, vetëm duhej të defilohej përmes këtij procesi. Dolën llogaritë e gabuara sepse luajtën në një letër të një kandidati pa identitet dhe integritet njerëzor, kombëtar, politik dhe moral, mashtrues i imtë, me përfitime të mëdha! Ishte rast tipik i gabimit; parti e fuqishme me një kandidat të tredhur! Pikërisht e kundërta ndodhi me kandidatin e PDK-së, Uran Ismaili; u tregua

kandidat shumë i fortë në garën për të parin e Prishtinës por dega e PDK-së në Prishtinë ishte impotente, e pafuqishme për t'i shkuar pas në këtë garë. Me një fushatë jotipike siç ishim mësuar më parë, Uran Ismaili rriti numrat e PDK-së në Prishtinë. Si përfundim, Përpa u zgjodh kryetar i Prishtinës, V-ja kishte më së shumti asambleistë kurse PDK-ja hyri në koalicion me LDK-në duke i ndarë postet sipas parimit, unë ty dhe ti mua.

A do të mbytet Përparim Rama në Badoc? Me naivitetin tim pata besuar se Rama mund të bëjë punë të mira për krejtëtin pasi qenka arkitekt i shquar me përmasa botërore. Në aspektin kombëtar nuk kam pasur asnjë mëdyshje për faktin se Rama rrjedhë nga një familje që në Llap e kemi vlerësuar: "as hajri i turkut e as sherri i shkaut ..." por ishte një familje intelektuale dhe e ndershme. Kur i fitoi zgjedhjet, lirisht mund të thuhet se e kishte përkrahjen e të gjithëve për të bërë punë të mira siç edhe kishte premtuar. Doli të jenë vetëm premtime kurse ora e zhvillimit të Prishtinës u kthye së prapthi pas kurdies që i bëri Rama. Doli me një eksperiment idiotesk ku konstatoi se pikërisht rruga midis Katedrales dhe kompleksit universitar qenka më e ndotura (pas matjeve) prandaj duhej të mbyllej (përkohësisht) për automjete përjashtuar taksitë, ndihmën e shpejtë, policisë dhe xhipave të Albin Kurtit, Vjosa Osmanit dhe Glauk Konjufcës. Me këtë shkaktoi kaos të paparë të trafikut urban që e bllokoi tërë qytetin. Bllokimi i përkohshëm u bë i përhershëm përkundër kundërshtimit të qytetarëve, mendimin e të cilëve paturpësisht e shpërfilli. Për të vendosur një baraspeshë, ekskluzivisht në baza fetare po planifikon që rrugën nga udhëkryqi i Katedrales deri te Sheshi i Flamurit të bëjë një pedonale, të ndaluar për automjete. Paranoja prodhon rezultate të pabesueshme, me një të rame (bllokimi i rrugëve) i arrin

dy të vrame; Katedralen e shndërron në një oazë të rrethuar nga të gjitha anët vetëm me kalimtarë kurse Xhaminë e lë gjithashtu pa vetura rreth saj. Në planin e mirëmbajtjes së pastërtisë, Prishtinën e ka shndërruar në kryeqytet të plehrave sikur dikur Napoli kur askush nuk mund të fitonte tender për pastrim pa lejen e Cosa Nostras apo Ndragetas napoletane. Përparim Rama premtoi se Prishtina do të blejë mjete të mjaftueshme për heqjen dhe riciklimin e plehrave kurse, deri më tani nuk e ka blerë asnjë (është në proces të tenderimit) kurse Prishtina u bë mal i bërillotit. Bleu bicikleta ekologjike me çmim aspak ekologjik (për buxhetin) madje bicikleta elektrike që nuk i kanë as Washingtoni, Parisi, Nica, Monako, Barcelona, Dubai dhe vendet e tjera që fitojnë miliarda euro nga turizmi. Po përpiket ta promovojë një turizëm ekologjik në një mjedis ku hapësira ndahet proporcionalisht 40% për qytetarë, 30% për plehra dhe 30% për qenë endacakë dhe ata që e kanë fituar statusin e rezidentit. Prishtinën e ka shndërruar në qytet të pajetueshëm për qytetarë dhe eldorado për qenë endacakë dhe ata me status të rezidentit (shenjë identifikuese në vesh). Kjo është Prishtina aktuale e kryetarit Përparim Rama, arkitetktit të "shquar" nga Londra e Gollakut. Në planin infrastrukturor dhe hapësinorë Prishtina mund të konsiderohet si mjedis urban vetëm në saje të asaj që e ka lënë si trashëgimi Isa Mustafa, kryetari ma i suksesshëm, në mos edhe i vetëm i Prishtinës. Po, Isa Mustafa për të cilin Përparim Rama thoshte se është muzikant në përpjekje për ta zhvlehtësuar punën e tij. Çfarë lladike! As Badovci nuk do ta lajë në të ardhmën nëse edhe nuk e fundosë politikisht dhe jo vetëm politikisht.

Ku plasën raportet dhe pse plasën: As në imagjinatën më të skajshme nuk mund të parashihej se Prishtinën do ta udhëheq një

kryetar më i qullët se Shpend Ahmeti. Kurrë mos thuaj kurrë, Shpend Ahmeti po del të jetë Karavaxho apo Arkitekt Sinani krahasuar me Përpën. Partnerët e koalicionit kishin probleme në ndarjen e hapësirës për biznes gastronomik (vendosje të shëpizave të vogla në sheshin e Prishtinës) por disi i tejkalonin. Hapësira për biznes gastronomik ndahej në bazë të përkatësisë politike apo sipas parimit të Fondit Ndërkombëtar Monetar (duke paguar para kesh për një shtëpi ..). Prandaj edhe këto biznese gjithmonë dilnin fitues përkundër tërheqjes "transparente" të shorteut! Pisa të pafytyrë! Plasja e madhe dhe duket e pakthyeshme ndodhi kur PDK-ja e bojkotoi seancën e Kuvendit të Prishtinës ku u votua për ndërrim të pronave te Liqeni i Badovcit me tokat e një paralagje të Marecit dhe Hajvalisë. Kjo i bie sikur të ndërroni tokat e Floridas me hapësirat e shkretëtirës së Saharasë apo të Gobit. Kuvendi për këtë ndërrim kriminal ishte koordinuar midis udhëheqësve të LDK-së dhe VV-së (të cilët deklaruan se vetëm e bënë punën e tyre duke ua siguruar kuorumin për marrje të një vendimit kriminal). Unë nuk e di pse PDK-ja ka kundërshtuar këtë ndërrim të pronave, për shkaqe parimore apo të tjera që i quaj joparimore por është befasues reagimi brutal i Përparim Ramës tash Përparim Ramës që pa asnjë paralajmërim shkarkoi drejtorin e PDK-së, Ilirik Musliu duke arsyetuar përmes rrjeteve sociale se ka dështuar në politikën e menaxhimit të mbeturinave në kohën kur pikërisht Përparim Rama nuk e ka bërë as edhe përpjekjen më të vogël për sigurimin e kamionëve sikur edhe për trajtim më të njerëzishëm për të punësuarit që trajtohen me keq se në kohën kur robërit ishin të legalizuar në ShBA. Për mua ka qenë nën çdo dinjitet reagimi i PDK-së ndaj këtij shkarkimi e mos të flasim për reagimin e Ilirik Musliut. Ky drejtor i shkarkuar nga

Përparim Rama ka thënë se shkarkimi u bë pasi Përparim Rama, bashkë me Lumirin e mbushën mirë e mirë cullën në njërën nga restorantet e kryeqytetit të njerëzve, qenve dhe bërllotit. Me një fjalë, ata paskanë hëngër kurse këtij i janë mbushur brekët! Po të reagonte menjëherë PDK-ja, Përparim Rama nuk do të kishte mundësinë ta shkarkonte edhe nënkryetaren e PDK-së, zonjushën Sahatçiu. Nëse vazhdon me këtë ritëm tash ka mbetur që Përparim Rama t'i shkarkojë edhe 4 drejtorët e tjerë të PDK-së duke i përcjellur me nga një shkëlqim bythëve. PDK-ja është dashur menjëherë ta prishë koalicionin e të mos lejojë të përbuzet në këtë mënyrë. PDK-ja, si çdo parti tjetër duhet t'i mbrojë anëtarët e saj nga keqbërësit dhe bijtë dhe bijat e komunistëve, ndryshe do të ikën përlesh. Përparim Rama, në marrëveshje me noterin e Vojsa Osmanit, Lumir Abdixhiku, që të dy të rritur dhe zhvilluar në një strofull komuniste, kanë vendosur ta përzënë PDK-në nga koalicioni duke e bërë një koalicion tjetër; Koalicionin e Badovcit, LDK-ja me VV-në. Qysh më herët një eksponent mercenar dhe paramilitar me emrin Hekuran Murati e paska bërë vlerësimin e pronave në Badovc sikur të bëhej fjalë për fshatrat e mbetura dhe të pabanuara të Shumadisë apo të Kurshumliës. Qartazi po duket se Përparim Rama nuk ka ardhur në Prishtinë për ta zhvilluar Prishtinën por për të bërë para prandaj shpesh deklarohet se i duhen dy mandate për përmbushje të misionit të tij; mandati i parë për të bërë para kurse mandati i dytë për të bërë shumë para. Badovci duhej të shërbente si urë lidhëse midis dy mandateve, nga të bërit para e deri te të bërit shumë para. Për momentin ka dështuar, por se nuk do të thotë se kësaj përpjekjeje i është vënë pika, është një presë pa asnjë pikëpyetje për qëllimin e fundit! Që të bëjë shumë para!

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Konsum
Servisim
Përcjell



‘Dardanët’ zhvillojnë dy miqësore në mars, një në qershor

Prishtinë, 6 shkurt - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka aranzhuar tri ndeshje miqësore, dy për muajin mars dhe një për muajin qershor. Fillimisht më 22 mars “Dardanët” do të luajnë kundër Armenisë në Yerevan, ndërsa më pas më 26 mars do të përballen me

Hungarinë në Budapest. Testin e radhës Kosova do ta ketë më 5 qershor, ku do të luajë kundër Norvegjisë në Oslo. Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se është në bisedime për aranzhimin edhe të miqësorës së dytë për qershor dhe shumë shpejt do

të konfirmohet edhe kundërshtari tjetër. “Këto miqësore do të shërbejnë që ekipi dardan të përgatitet sa më mirë për ndeshjet zyrtare në vjeshtë në kuadër të Ligës së Kombeve, shorti i së cilës garë do të tërhiqet më 8 shkurt”, thuhet në njoftimin e FFK-së.



Përzgjidhen 42 bursistë ‘Shpresa Olimpike 2024’



PRISHTINË, 6 SHKURT - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) do ta vazhdojë mbështetjen për sportistët. Këtë herë ka përzgjedhur 42 bursistë “Shpresa Olimpike 2024”. Bursistët, që

vijnë nga 19 sporte olimpike, i takojnë moshës deri në 21 vjet. Sportistët do të mbështeten nga KOK-u me nga 150 euro në muaj përgjatë gjithë vitit 2024. Përzgjedhja e 40 të tillëve është

bërë nga komisioni i sportit, pas nominimeve të dërguara nga federatat, ndërsa dy bursistë u shtuan me propozim të Bordit Ekzekutiv. Listës iu shtua edhe notarja Hana Beiqi, përkundër

mosnominimit nga Federata e Notit e Kosovës. Gjatë vitit të kaluar KOK kishte ndarë 35 bursa për sportistët e rinj. Javë më parë KOK-u përzgjedhi edhe 10 bursistë të tjerë, të cilat mbështeten nga MKRS-ja, sipas rregullores nr. 03.2013 për ndarjen e bursave për shpresat olimpike dhe paralimpike.

LISTA E SPORTISTËVE:

Dëbora Gjakova (Xhudo), Muhamedin Veseli (Xhudo), Blerina Gashi (Xhudo), Besjana Gashi (Xhudo), Sidorela Dodaj (Xhudo), Laurina Gashi (Xhudo), Mal Agushi (Tenis), Salidin Rama (Tenis), Dris Sejdiu (Shenjëtari S.), Adriatik Berisha (Mundje), Egzon Xhoni (Mundje), Hana Bejiqi (Not), Mal Gashi (Not), Vilëza Zeqiri (Gjimnastikë), Valëza Rama

(Gjimnastikë), Fleta Deçani (Kajakim), Lenë Osmani (Pingpong), Shega Hashani (Pingpong), Blend Hajdari (Pingpong), Visar Nuhaj (Çiklizëm), Amar Maxhuni (Triatlon), Genc Isufi (Triatlon), Emine Jonuzi (Atletikë), Medina Kutleshi (Atletikë), Enis Bytyqi (Atletikë), Olti Bytyqi (Atletikë), Ensar Badallaj (Boks), Luan Morina (Boks), Denis Bllaca (Taekwondo), Elion Agushi (Taekwondo), Mal Sahiti (Taekwondo), Andi Pupovci (Skitari), Klara Sefaj (Skitari), Valmir Gllareva (Shigjetari), Anita Krasniqi (Futboll), Aurora Maliqi (Futboll), Olsi Mulaj (Hendboll), Arona Krasniqi (Hendboll), Malvina Haziri (Basketboll), Yll Kastrati (Basketboll), Erion Bajra (Volejbol), Jona Krasniqi (Volejbol).

Auditori gjen parregullsi në projektet e tri stadiumeve, Çeku: Kemi marrë masat e duhura

Prishtinë, 6 shkurt - Probleme me shpronësimin, vonesa në zbatimin e punëve si dhe plotësimin e kushteve kontraktuale janë disa nga të gjeturat e raportit të Zyrës së Auditorit për stadiumin “Adem Jashari në Mitrovicë”, atë të Gjilanit si dhe të Gjakovës. Anëtarja e komisionit për mbikëqyrjen e financave Mirlinda Tishukaj-Sadiku duke dhënë detaje nga të gjeturat e këtij raporti ka thënë se

për stadiumin “Adem Jashari” problemi kryesor ka qenë shpronësimi. Parregullsi me pronën auditori ka gjetur edhe te stadiumi i qytetit të Gjilanit, ndërsa vonesa të shumta dhe mosrealizim të kontratave janë gjetjet sa i përket stadiumit të qytetit në Gjakovë. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka thënë se kanë shkëputur kontrata e operatorëve për shkak se nuk i kishin kryer

punimet sipas kontratave të lidhura dhe kanë nisur procedurë të re të prokurimit. Ndërsa për stadiumin “Adem Jashari”, Çeku theksoi se tashmë janë kaluar të gjitha pengesat dhe se janë ndarë rreth 13 milionë euro për renovimin e tij. I pari i MKRS-së ka theksuar se kjo ministri është e gatshme të paguajë para shtesë për operatorët që kryejnë punët me kohë dhe kanë nevojë për buxhet shtesë për shkak të punimeve që mund të nevojiten.



Rrahmani në formacionin e javës në Rumani

BUKURESHT, 6 SHKURT - Sulmuesi Albion Rrahmani ka nisur ta rikthejë formën e dikurshme pas lëndimit të rëndë që e kishte pësuar vitin e kaluar. Reprezentuesi

“dardan” shkëlqeu në fundjavë duke e shënuar njërin nga dy golat e Rapid Bukureshtit në fitoren 2-1 ndaj Otelulit. Kjo ka bërë që Rrahmani të zërë vend në

ekipin ideal të xhiros së 24-t në ligën elitare të Rumanisë. 23-vjeçari i ka realizuar tetë gola deri tash në këtë edicion, ndonëse ka luajtur shumë pak, ndërsa i ka bërë

edhe dy asistime. Formacioni (4-3-3): Sava, Vladoiu, Larie, Benga, Mascerenhas, Keita, Cretu, Alhassan, Bauza, Rrahmani, Omondi.

Simeone i bën ftesën e papritur Modriqit: Eja të luash me ne

Madrid, 6 shkurt - Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, i ka bërë ftesë Luka Modriqit t'i bashkohet atij në "Wanda Metropolitano" sezonin e ardhshëm. 38-vjeçari ka vetëm

katër muaj të mbetur nga kontrata e tij me "Los Blancos". Kjo është fushata e tij e fundit në "Santiago Bernabeu". Modriqi nuk ishte titullar në barazimin 1-1 të "Los Balncos" kundër Atleticos në

derbin e Madridit të dielën e kaluar. Ai hyri në lojë në minutën e 76-të, por jo përpara se Simeone t'i thoshte një fjalë të shpejtë buzë fushës. "DAZN" pretendon se trajneri argjentinas i kërkoi pesë

herë fituesit të Ligës së Kampionëve dhe "Topit të Artë" të bashkohej me "Los Colchoneros". Ai dysohet se ka thënë: "Luka! Luka! Bashkohu me ne dhe eja të luash me ne!"



Nis punën Përfaqësuesja U16

PRISHTINË, 6 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të talentëve për ekipet përfaqësuese, duke krijuar edhe ekipin Përfaqësues U16, nën përkujdesjen e trajnerëve të shquar të gjeneratave të reja, Mehmet Kurda, Ibrahim Domi, Fadil Ademi dhe Burim Sadiku. E pikërisht ka nisur edhe puna në terren e Përfaqësueses U16, ku janë ftuar 20 futbollistë nga kampionati vendor, e të cilët më herët kanë qenë pjesë e ekipit përfaqësues U15. "Drejtuesit e stafit teknik janë të angazhuar që të identifikojnë dhe zhvillojnë potencialin e këtyre lojtarëve të rinj, por edhe lojtarëve të tjerë të kësaj grupmoshe në javët dhe muajt në vazhdim, duke përfshirë edhe lojtarë që luajnë jashtë vendit. Grumbullimi i parë ka sjellë një fond të pasur të lojtarëve, duke përfshirë sulmues të shkëlqyeshëm, mesfushorë të shpejtë dhe mbrojtës të spikatur", thuhet në njoftimin e FFK-së.



Trajneri Mehmet Kurda ka shprehur bindjen se ky grup ka potencialin për të krijuar një harmoni të fuqishme dhe një dëshirë të theksuar për të përparuar dhe për t'i shërbyer me krenari përfaqësueses. Ai ka thënë se qëllimi i formimit të Përfaqësueses U16 është të krijimi i një bazë të fortë talentesh për të ardhmen dhe të sigurojë që Përfaqësuesja U17 të

ketë lojtarë cilësorë e me përvojë në kualifikimet e ardhshme. Përfaqësuesja U16 prej 1 marsit deri më 7 mars do të marrë pjesë në turneun zhvillimor të UEFA-s në Tiranë, prandaj stafi teknik synon që çdo javë të ketë nga një grumbullim në Kampin Nacional në Hajvali, në mënyrë që ekipi të përgatitet sa më mirë për këtë aktivitet.

Lakersat gjejnë ritmin e fitoreve, triumfojnë edhe Dallasi, clippersat dhe Golden State

Brooklyn, 6 shkurt - Fitorja e tretë radhazi për lakersat, që mundën me rezultat 124-118 Charlotten dhe ngjisin disi shkallët në renditje në Konferencën e Perëndimit. Ndeshje me rivalitet, ku u dallua Russell me 28 pikë si dhe Jamesi e Davisi me nga 26 pikë secili. Fitoi edhe skuadra e clippersit, që falë 36 pikëve të Leonardos dhe 30 të Hardenit, mundi 149-144 Atlantan. Skuadra e Dallasit fitoi në fushën e Philadelphias (118-102), një përballje e dominuar nga miqtë. 6 lojtarë të Dallasit realizuan mbi 14



pikë, duke bërë diferencën në fushë. Ekipi i New Orleansit mundi kanadezët e Torontos (138-100), sfidë ku shkëlqeu Brandon Ingram, autor i 41 pikëve. Clevelandi bëri detyrën, duke mundur me rezultat 136-110 Sacramenton, ndeshje pa

shumë histori, ku u dalluan Allen e Mitchell, me nga 29 pikë secili. Rikthehet te fitorja ekipi i Golden States, që triumfoi 109-98 ndaj Brooklynit jashtë fushe. Curry me 29 pikë e Cuminga me 28 ishin më të mirët në fushë për Warriorsin.

Rezultatet

Charlotte - Lakers	118-124
Cleveland - Sacramento	136-110
Philadelphia - Dallas	102-118
Atlanta - Clippers	144-149
Brooklyn - Golden State	98-109
New Orleans - Toronto	138-100

SHKURT

Hamiltoni te Ferrari do të përfitojë pagë rreth 60 milionë euro

Lewis Hamiltoni do të jetë pjesë e Ferrarit nga viti 2025, teksa do të jetë piloti i dytë i "kokëkuqes" pas monegaskut Charles Leclerc. Por, ky fakt, duket se nuk e pengon skuadrën italiane që ta paguajë britanikun me thujse dyfishin e pagës që merr Leclerc. Ky i fundit paguhet 30-35 milionë euro në vit, teksa "The Telegraph" ka raportuar se shtatë herë kampioni i Botës do të marrë një rrogë 50-60 milionë euro në vit. Gjithsesi vendin e parë vazhdon ta mbajë kampioni i Botës në fuqi, Max Verstappen, i cili te Red Bulli merr një pagë prej 64 milionë eurosh në vit.

De Gea vazhdon të jetë lojtar i lirë

David De Gea vazhdon të jetë ende pa skuadër. Spanjoli konsiderohej një nga portierët më të mirë në botë, por që nga largimi prej Manchester Unitedit vazhdon të jetë lojtar i lirë. Ofertat nuk mungojnë, por 33-vjeçari nuk është i kënaqur me këto oferta dhe vazhdon të mbetet i paangazhuar në ndonjë skuadër. Oferta e fundit ishte nga Nottingham Foresti, por nuk kanë munguar edhe raportimet për një rikthim të spanjollit në "Old Trafford" pas paraqitjeve zhgënjyese të kamerunasit, Andre Onana, ndërsa një tjetër opsion është kalimi tek Newcastle Unitedi, pas dëmtimit afatgjatë të Nick Pope.

Pesë lojtarë në verë do të largohen nga Barcelona

Barcelona pritet të bëjë shumë ndryshime pas përfundimit të këtij edicioni. Presidenti Joan Laporta po planifikon të shesë lojtarë të rëndësishëm. Sipas gazetës "Sport", Barcelona do të përpikët të transferojë pesë lojtarë gjatë verës, dy prej të cilëve do të jenë lojtarë të rëndësishëm. Dy do të largohen në fund të kontratave të tyre si Sergi Roberto dhe Marcos Alonso. Ndërkohë që në verë do të largohet edhe Oriol Romeu, i cili u soll me kërkesë të Xavi Hernandezit. Emrat e mëdhenj që do të largohen do të jenë Raphinha dhe një qendërmbrojtës. Kjo e fundit duket të jetë një çështje e hapur në varësi të interesit, me Jules Kounde, Andreas Christensen dhe Ronald Araujo, të gjithë në kombinim. Ndërsa Barcelona synon t'i blejë përfundimisht kartonët e Joao Cancelo dhe Joao Felix.

Karton i kuq i përkohshëm, gati rregulli i ri në futboll

Pas VAR-it, bota e futbollit bëhet gati për një tjetër risi që, me gjasë, do ta marrë dritën jeshile për t'u eksperimentuar në muajin mars, në mbledhjen e IFAB. Bëhet fjalë për përjashtimin e përkohshëm të futbollistëve, një rregull i ri që pritet të testohet në FA Cup duke nisur që nga sezoni i ardhshëm. Përjashtimi i përkohshëm parashikon lënien jashtë të një futbollisti për një kohë maksimale prej 10 minutash, megjithatë mbetet ende të përcaktohet kohëzgjatja. Në kategorinë e faulleve që pritet të ndëshkohen me përjashtim të përkohshëm janë faulle taktikë, por edhe protesta të ashpra të futbollistëve ndaj vendimeve të gjyqtarëve. Bashkë me këtë risi pritet të diskutohet edhe një ide tjetër, ajo e komunikimit me gjyqtarin vetëm nga ana e kapitenëve të skuadrave, ashtu si në ragby.

Eto'o jep dorëheqje, Komiteti Ekzekutiv e refuzon

Samuel Eto'o ka dhënë dorëheqje nga pozicioni i tij si president i Federatës së Futbollit të Kamerunit. Është lëshuar një deklaratë zyrtare duke shpjeguar zgjedhjen, por në të njëjtën kohë saktësohet se Komiteti Ekzekutiv e ka refuzuar dorëheqjen e Eto'os.

"Presidenti i Federatës së Futbollit të Kamerunit, Samuel Eto'o, ka dorëzuar dorëheqjen e tij para anëtarëve të organit ekzekutiv federal, duke i ftuar ata të bëjnë të njëjtën gjë me gjithë shpirtin dhe ndërgjegjen e tyre. Në fund të debatit dhe diskutimit

pasues, anëtarët e Komitetit Ekzekutiv vendosën ta vazhdojnë mandatin e tyre aktual dhe më pas refuzuan unanimisht dorëheqjen e presidentit të Federatës së Futbollit Kamerun, duke rinovuar të gjithë besimin e tyre tek ai për të vazhduar me të

njëjtin shtysë, punën e rindërtimit dhe zhvillimit të futbollit kamerunas, nga baza në krye, siç e parashikoi ai në projektin e tij të vlerësuar gjatë Asamblesë së Përgjithshme zgjedhore të 11 dhjetorit", shkruhet në njoftimin e Federatës.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Kijeva Group BSV” Sh.p.k. – Malishevë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Objekt afarist pompë derivatesh me etazhitet P+0 në Kijevë, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.03.2024 në ora 10:00 në Shkollë -SHMP Lasgush Poradeci, Kijevë, Malishevë, do të organizohet debat publik nga Kompania “Kijeva Group BSV” Sh.p.k. – Malishevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82379546934?pwd=LB71bMdAsobPCLHcq5lpqwcZo2IRZ7.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Kijeva Group BSV” Sh.p.k. – Malishevë për Objekt afarist pompë derivatesh me etazhitet P+0 në Kijevë, Malishevë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Matrix Digital” L.L.C. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr: 810084129.

- Resul Ramadani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Leke Dukagjini” Prizren.

- Votim Cikaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Luigj Gurakuqi” Nashec.

- Urim Shabanaj shpall të pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Meriton Kirobi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Kadri Kusari”.

- Nikollë Prenaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

- Mizajete Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës fillore “Gani Morina”.

- Jehona Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “Hajdar Dushi” Gjakova.

- Halil Mala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Artan Ademaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SH.M.E “Kadri Kusari”.

- Jehona Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “Luigj Gurakuqi”, Korenicë.

- Ylfete Spasi (Vehapi) nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Hajdar Dushi”.

- Mefide Qarhaxhije (Zajmi) nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Hajdar Dushi”.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallën dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)





TRADITË QË NGA 1992

